

Evalda PACI

**HISTORIKU I VEPRAVE TË LETËRSISË SË VJETËR SHQIPE,
NJË PREMISË E RËNDËSISHME NË TRAJTIMIN ANALITIK E
NJOHËS TË TYRE**

Abstrakt:

Në këtë trajtesë sintetike nënvizojmë rëndësinë e njohjes së thelluar të rrethanave të përvijimit apo inicimit të veprave të letërsisë së vjetër shqipe, të lidhura ngushtë dhe me institucione të shtypshkrimit në areale të caktuara të zhvillimeve kulturore në Evropë. Një argument i tillë ka tërhequr vëmendjen e studiuesve të teksteve të vjetra shqipe, të orientuar prej kohësh dhe ndaj plotësimit të kontekstit historik të realizimit të veprave të letërsisë shqipe të shekujve XVI-XVII. Në një kohë të afërt me realizimin e këtyre veprave themelohen apo konsolidohen ente të shtypshkrimit dhe vatra të editorisë në arealin italik, fakt që sheh të përfshirë dhe autorët e tyre, në veçanti përpilues doracakësh apo fjalorë, tek të cilët mund të gjurmohet dhe e shprehur njohja e hallkave hierarkike të lejimit për shtyp. Autoritete të lejimit për shtyp marrin një rëndësi të shtuar në vitet e dekadat që pasojnë përmbylljen e punimeve të Koncilit të Trentit (1545-1563), duke u gjendur të përmendur dhe në tekstet hyrëse të veprave të sipërcituara. Prania e roli i tyre shënon ndjeshëm dhe historinë e veprave të letërsisë kishtare në gjuhën shqipe, të realizuara në shekullin XVI e më tej.

Fjalë kyçe:

Historik, kontekst historik, shqipërim, tipografi, tematikë specifike.

Duke qenë një prej periudhave më të trajtuara në objektin e disa disiplinave studimore, e përfaqësuar prej përpilimesh që kanë pasur një paracaktim të lidhur me tematika konkrete, letërsia e vjetër shqipe përbën dhe sot e kësaj dite një argument të gjerë diskutimi, duke nisur pikërisht nga shkalla e njohjes së historisë së përvijimit të secilës prej tyre.

Tradita studimore mbi fillimet e dëshmimit shkrimor të gjuhës sonë nuk ka ndarë plotësisht në rasë të përgjithësimi mbi këtë periudhë çështjet e konsiderimit të këtyre veprave në bazë të diferencimeve tematike, fakt që u përket më tepër trajtesave më të thelluara mbi botimet e realizuara në shekujt XVI-XVII, me një sërë hollësish për t'u vënë në dukje në lidhje me motivimin përkatës, të dhënat që disponohen mbi autorë të veçantë, por dhe mbi rrjedhën e proceseve që shoqëruan daljen në dritë të shtypit të tyre. Të trajtuara në punime që kanë pasur objekt të studimit historinë e letërsisë së shkruar shqipe, por dhe historinë e shkrimit shqip, për këto vepra është treguar një vëmendje e spikatur që pavarësisht pikëpamjeve të shprehura, apo kushtëzimit nga faktorë të caktuar para disa dekadash, i ka bërë ato të jenë pjesë e sprovave kolegjiale që mbeten referenciale dhe në ditët e sotme.¹

Një periudhë e tillë, trajtohet tradicionalisht duke marrë në konsideratë dhe dëshmi fragmentare më të hershme në kohë, të bëra gjithashtu objekt trajtimi në punime të posaçme, ndër të cilat do të veçonim dhe atë të Namik Resslerit (1908-1985), të botuar në format të një pune të thelluar në vitin 1978, nën titullin analitik "*I più antichi testi albanesi*", me një sërë trajtesash mbi tekstet përkatëse,² me një aparat kritik që bën të mundur dhe t'u kthehemi sërish kontributeve paraardhëse në kohë, që kanë objekt trajtimi të njëjtat dëshmi shkrimore. Me trajta të përveçme që dhe mund të evokojnë përdorime që mund t'i ndeshim në veprat e letërsisë së vjetër shqipe që janë për më tepër dhe rezultat i një teknologjie (shtypshkrimit) që po hidhte hapa të qartë përparimi, rreth këtyre dëshmimeve janë kryer dhe realizuar si diskutime *ad hoc*, ashtu dhe punime që mëtojnë t'u japin përgjigje dhe çështjeve të një kronologjizimi më të saktë, fakt që do t'i shërbente më së miri dhe vetë historisë së shkrimit shqip dhe hapave të përvijimit të tij në kohë e në fakte konkrete. Namik Ressler në veçanti kishte vite që ishte bërë pjesë e një historiku arritjesh dhe trajtesash, duke qenë bashkëdrejtues i një projekti me objekt autorë e tekste në lidhje me letërsinë shqipe të disa periudhave, e cila botohet për herë të parë në fillim të viteve '40-të në gjuhën shqipe, me një

¹ Një vëmendje e qartë ndaj kësaj periudhe dhe veprave që e përfaqësojnë mund të gjurmohet dhe në botimet institucionale (ndër të tjera ato të viteve 1959, 1983) me disa autorë, që i kushtohen veçanërisht historisë së letërsisë së shkruar shqipe, të parë në një vështrim sa kronologjik, aq dhe analitik e tematizues. Shih në veçanti botimin *ad hoc* me titull "*Historia e letërsisë shqipe*", botim i Universitetit të Tiranës, Tiranë, v. 1, 1959, v. 2, 1960; shih sërish botimin me titull "*Historia e letërsisë shqiptare*", botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë 1983.

² Namik Ressler, *I più antichi albanesi*, Giappichelli editore, Torino, 1978.

sërë referencash autoriale dhe tekstore.³ Edhe botimi i një vëllimi të plotë që përbën të parën shfaqje në përmasa të një formati ekdotik të librit të Gjon Buzukut (botuar nga Biblioteca Apostolica Vaticana, Romë, 1958) e riafirmon prirjen e tij për t'i dhënë një lamijeje të përveçme siç paraqitet ajo e studimit të teksteve të vjetra shqipe një ndihmesë të çmuar në pikëpamje të pajisjes me studim hyrës dhe analitik, por dhe të një aparati ndihmës në tekste e burime referenciale, siç paraqiten dhe shtojcat që pasojnë shtjellimin e vet botimit në fjalë.⁴

Vetë periudha në të cilën sheh dritën e botimit ky vëllim kritik dhe ekdotik mbi *Mesharin* nga ana e Namik Resslerit shënohet nga një sërë arritjesh të lavdërueshme në pikëpamje të studimit të teksteve të vjetra shqipe dhe njëkohësisht të historikut të veprave përkatëse, duke qenë se në buletinet shkencore vijnë radhazi disa studime të E. Çabejt mbi të njëjtin argument, si dhe shtrohen trajtesa në pikëpamje shtjelluese mbi një traditë studimesh që

³ Namik Ressler, *Shkrimtarët shqiptarë: nga Buzuku tek arbëreshët e Greqisë, Pjesa I, Tiranë, 1941; botimi i dytë*: Botime Pakti, Tiranë, 2007.

⁴ Në të vërtetë, gjetja e teksteve më të afërta referenciale që mund të jenë përdorur në rasë të përpilimit të librit të Gjon Buzukut ka qenë dhe mbetet një prej çështjeve më të trajtuara në traditën e brendësimit përmbajtësor të pjesëve përbërëse të tij. Për vetë kompleksitetin e brendisë, por dhe për faktin që në pjesë të caktuara përbërëse përmbajtja ndaj tekstit kanonik ishte një çështje normative, dhe vetë evidentimi i teksteve që janë konsultuar në përpilim është i rëndësishëm për studiuesit e veprës. Në vëllimin e vitit 1958 të përgatitur nga N. Ressler një shtojcë e plotë në tekste dhe incipit-e lutjesh e pjesësh biblike mund të ndihmojë studiuesin në ndërtimin e përqasjeve apo krahasimeve në pikëpamje të shqipërimin, apo të përshtatjeve të mundshme të realizuara nga autori. Në vëllimin e dytë të botimit kritik e filologjik të vitit 1968, që kemi trajtuar dhe në punimet tona të mëparshme e që është përgatitur nga E. Çabej, shënime të caktuara që nuk kanë në qendër të vëmendjes vetëm tipare të veçura të shkrimtarisë apo përdorimeve gjuhësore të autorit, ndihmojnë së tepërmi si në referimin ndaj librash kishtarë që mund të jenë modele më të afërta të konsultuara, ashtu dhe në kuptimin e duhur të trajtave të caktuara, që interpretohen dhe mbi vetë formimin e dëshmuar prej përpiluesit. Referencialitetin ndaj teksteve të Vulgatës latine e gjejmë të shprehur në mënyrë konkrete dhe në punimin e vitit 1960 të përpiluar nga Martin Camaj (1925-1992), i cili analizon në krerë të caktuar pothuaj çdo aspekt përmbajtësor dhe ndërtimor të kësaj vepre, duke ndërmarrë analiza që hedhin dritë mbi nënsisteme të veçanta, por duke mos lënë jashtë vëmendjes dhe vetë krahasimet me tekste në variante të tjera biblike, përfshirë dhe ato të përdorura në arealin kroat. Ndikimi latin dhe ai latino-roman mund të dëshmohej në disa aspekte, por në vështrimin studimor vetë terminologjia që qëndron në themel të vetë tematikës së librit dhe një sërë regjistrash gjuhësorë që shtjellohen në rubrika e krerë të përveçëm, bëjnë të mundur të reflektohet mbi vetë formimin e autorit apo përpiluesit, i cili dhe në pikëpamje ndërtimesh sintaksore vërteton argumentimin e sipërcituar.

do të kishte në vëmendje dhe shkrimet e vjetra shqipe.⁵ Një vit më parë do të themelohej nga Ernest Koliqi (1903-1975) dhe revista *Shëjzat*, një e përkohshme që dha kontribute të njëpasnjëshme në disa nënfusha të studimeve letrare, përfshirë vetë historinë e letërsisë së shkruar shqipe dhe ndërthurjen e vështirimeve nga disa disiplina, fakt që i dha kësaj të fundit një profil të veçantë gjatë gjithë ekzistencës së saj disavjeçare.

Në pikëpamje koherence me realizime të ngjashme librare, duke qenë se fundi i shekullit XV dhe dekadat e para të shekullit XVI lidhen me zhvillime të rëndësishme në fushë të teknologjisë që lidhet me librin dhe përhapjen e tij në rrethe kryesisht të kulturës, dalja në dritë të shtypit e veprave që përfaqësojnë këtë traditë letrare e shkrimore dëshmon koherencë me prurjet në fushë të kulturës së lëvrimin libror, por dhe përfshirjen me ente të shtypit që hap pas hapi duket qartë që do të jenë të pranishme dhe në elemente përbërëse me rëndësi për përfaqësimin e këtyre veprave. Pajisja me një sërë tekstesh që shprehin hapa të proceseve që paraprijnë përmbylljen e veprës dhe finalizimin e saj në shtyp tregon dhe përafrimin me normat e kohës, më të unifikuara dhe pas përfundimit të punimeve të Koncilit të Trentit (1545-1563), i cili shënoi ndërkohë një fazë decizive për fatin dhe tematikat e librave kishtarë me një orientim më të përcaktuar nga hierarkia e kohës.⁶

Veprat e letërsisë së vjetër shqipe mund t'i përafrojmë natyrshëm me vetë Koncilin e sipërpërmendur, duke qenë se në faqet hyrëse dhe tekstet introductive të tyre do të mund të gjurmohet të shprehur qartë reflektimin e njohjes së këtij të fundit nga vetë përpiluesit dhe autorët e teksteve që përmbahen në to. Çështje të elementeve të liturgjisë që përmbahen dhe pasqyrohen në to, edhe nëpërmjet një gjuhe të kujdesuar, me praninë e siglave latine në çdo rubrikë e ndarje tematike, çështje të ruajtjes së ecurisë në kalendarin liturgjik që pasqyrohet natyrshëm dhe në modelet përkatëse, përmendja e vetë figurave që kanë pasur rol në konsolidimin e dekreteve të Koncilit Tridentin dhe rregullave të shumëpërmendura të tij, përbëjnë dëshmi të qarta të një vijimesie që në këto vepra gjurmohet hap pas hapi.⁷

⁵ E. Çabej, *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në *Buletin i Shkencave Shoqërore*, n. 2, 1959.

⁶ G. Fragnito, *La censura ecclesiastica in Italia: volgarizzamenti biblici e letteratura all'Indice. Bilancio degli studi e prospettive di ricerca*, në *Reading and censorship in Early Modern Europe*, Barcelona, 2010, f. 39-56.

⁷ Në frontespicin e botimit të parë të Dokrinës së krishterë (Romë, 1618) të shqipëruar nga Pjetër Budi do të mund të shquhen qartë referencat ndaj pontifikatit përkatës në të cilin shihet dritën e botimit kjo e fundit, si dhe ndaj përpilimit të modelit doktrinar nga ana e Roberto Bellarmino-s S.I (1542-1621). Çdo element i këtij frontespici, ashtu si dhe tekstet pasuese flasin qartë për një hierarki vlerash që shqipëruesi ynë i njihte mirë, duke qenë se i reflektonte

Kur bëhet fjalë për njohjen e historikut të këtyre veprave, sigurisht që vjen e domosdoshme për t'u marrë parasysh si kontekstualizimi përkatës në dritë të të dhënave kryesisht historike që kanë të bëjnë me një sërë rrethanash të përvijimit të tyre, ashtu dhe me vetë reflektimin e tyre në studimet tona, ndër të cilat dhe ato me vështrim mbi historinë e letërsisë së shkruar shqipe kanë një përparësi të spikatur.

Vetë trajtimi i veprave të letërsisë së vjetër shqipe në traditën e studimeve tona, kryesisht në përbërje punimesh si me iniciativë individuale, si kolegjiale dhe institucionale e dëshmon njohjen e kontekstit dhe të vetë qasjeve që për kohën kur do ta shihnin dritën e shtypit ishin vërtet të veçanta dhe të lidhura me një sërë zhvillimesh e prirjesh. Në dekada të caktuara, kryesisht në ato që i takojnë fillimit të shekullit të kaluar, vëmendja ndaj teksteve më të hershme në gjuhën tonë u reflektua bindshëm dhe ndjeshëm në të përkohshme që kishin dhe orientim kulturor, por më tej dhe në vepra më të tematizuara, në të cilat shihet qartë që autori apo autorët i kushtonin kujdes si përvijimit dhe inicimit të dëshmimit të shkrimit shqip, ashtu dhe përpilimeve që u realizuan në shekujt e përrurimit të shtypshkrimit në Europë dhe në viset italiane. Një prirje të qartë në pikëpamje të metodologjisë që do të duhej të parashtrohej nëse bëhej fjalë për botimin më të përafëruar në vështrim filologjik dhe kritik e shpreh herët dhe filologu frëng Mario Roques (1875-1961), i cili në një kohë të afërt me sprovat dhe përpjekjet e Atë Justin Rrotës O.F.M., por dhe me kontributet e Papas Gaetano Petrottës, u jep një shtysë konkrete çështjeve të studimit shkencor të teksteve të vjetra shqipe, duke hedhur dritë më tej si mbi tekste aprovimi të veprave përkatëse, ashtu dhe ndaj një konteksti tipik të cilin e përshkruan dhe falë kompetencave dhe formimit specifik si në fushë të filologjisë së tekstit, ashtu dhe në atë të historisë së gjuhëve të Evropës. Pasuria e çmuar që reflektohej në ekzemplarë unikë të veprave të letërsisë së vjetër shqipe të ruajtur në bibliotekat më të rëndësishme të botës evropiane evidentohet qartë dhe saktë nga Roques, i cili vë në dukje çdo element që mund të ndihmonte në plotësimin e pjesëve të munguara në historinë e secilës prej veprave në fjalë. Në punimin me titull

më së miri dhe në një ecuri të përcaktuar në pjesët e veprës së tij. Në këtë botim të parë të Dokrinës së Bellarminos, që në kohën kur botohet varianti i Budit ishte kardinal i kishës së Romës, gjinden të evidentuara tekste në gjuhën latine të aprovimit për shtyp dhe emra të përveçëm që janë pjesë e historikut të kësaj vepre. Në kuptimin e plotësimit të kuadrit të historikut të kësaj vepre, do të duhej të analizoheshin dhe ribotimet pasuese, që janë realizuar pas vdekjes së Budit, por që mbartin po aq qartë të njëjtat tipare, përfshirë faktin që vepërza në fjalë, mjaft e dobishme në procese të edukimit katekistik dhe fetar kishte tërhequr interesimin e enteve të shtypit të Kongregacionit të Propagandës, që themelohet disa vite më vonë, gjithnjë në shekullin XVII.

Recherches sur les anciens textes albanais, Paris, 1932, Roques jo vetëm analizon një pasqyrë dëshmish shkrimore që lidhen ngushtësisht me botën shqiptare dhe gjuhën e letërsinë shqipe, por dhe ofron një model të përshkrimit të ecurisë së realizimit të veprave më të hershme që njiheshin deri në atë kohë e që të evidentuara në një ecuri tipike që do të ruhet dhe në studime të mëvona, paraqiten në një dritë të plotë trajtimi dhe vlerësimi.⁸

Duke qenë se për realizimin për shtyp të këtyre veprave, qendrat e editorisë evropiane dhe në veçanti ato italike u bënë pjesë e historikut përkatës, vetë përmendja e tyre në elementet shënuese të veprës, bashkë me autoritetet që miratonin shtypjen e tyre janë pjesë e një mozaiku tipik që dëshmon tipare të një periudhe komplekse dhe me mjaft interes për të dhënat që mund të vilen sërish në lidhje me të njëjtin argument.⁹

Çështje të referencialitetit institucional në pjesët hyrëse apo më përfaqësuese në përmbajtjen e këtyre veprave janë trajtuar dhe më herët, në veçanti në punime apo sprova që kanë për orientim tematik vetë periudhën dhe në të njëjtën kohë dhe çështje të përgatitjes për botim të tyre, në një perspektivë të botimit kritik e filologjik, si një mundësi mjaft e mirë dhe më e përshtatshme për t’iu qasur në mënyrë të përafuar brendisë dhe nënndarjeve kryesore të tyre. Meritë e përgatitësve për botim, që rezultojnë ndër njohësit më të mirë të përmbajtjes, por dhe të kontekstit që bëri të mundur të realizohen të tilla vepra mbetet në vështirimin e studimeve të sotme qoftë puna e imët në përpilimin e varianteve të transliterimit dhe të transkribimit, ashtu dhe e një aparati të plotë që përveç parathënieve të zgjeruara, në përmasa studimesh të plota mbi veprat përkatëse, përmbajnë një sërë shpjegimesh dhe orientimesh ndaj hulumtimesh mbi tekstet, fjalët e veçanta, shenjat grafike që rezultojnë herë të përveçme, herë të krahasueshme me të tjera përpilime të afërta në kohë.

Nëse bëjmë fjalë për të vënë në pah njohjen e historikut të veprave të veçanta të letërsisë së vjetër shqipe, si pjesë e pandarë e vështirimeve që nuk ndajnë nga vëmendja as historinë e shkrimit apo të dëshmimit shkrimor të gjuhës sonë, për secilën duhet të ketë në trajtesat përkatëse apo përmbledhëse mbi të njëjtin argument nënvizime veçorish a rrethanash që lidhen si me profilin biografik të autorëve të veçantë, ashtu dhe me vetë zhvillimet përkatëse që kanë të bëjnë me entet botuese apo me autoritetet përkatëse që lejonin shtypjen e veprës.

⁸ Shih ndër të tjera dhe E. Paci, *Në përvjetor të 90-të të botimit të veprës “Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe”*, në *Hylli i Dritës*, n. 2, 2022, f. 49-59.

⁹ Shih në veçanti L. Nadin, *“Meshari” i Gjon Buzukut. Skenare të reja, të dhëna të reja*, në *Studime filologjike*, n. 1-2, 2019, f. 5-18.

Çështja e lejimit të veprave të caktuara me tematikë nga fusha të veçanta të dijes (gjithnjë u referohemi shekujve XVI-XVII), ka përfshirë gjerësisht dhe në masë të shtrirë në disa vende mjaft autorë, institucione, por dhe prirje që kanë të bëjnë me mendimin filozofik, me qasjet individuale apo institucionale ndaj tij, me përparimin e dijes së teologjisë, por dhe me receptimin e autorëve që me dijen e tyre u konsideruan që në kohë të tyre si pararojë me veprat që sollën. Një çështje e tillë gjen reflektim në sigla e sintagma, në të cilat spikasin dhe ato në gjuhën latine.

Sa u përket sintagmave me të cilat shënohet lejimi i veprës për shtyp, dhe në ato që përfaqësojnë letërsinë e vjetër shqipe gjinden ndërtime që evokojnë procese të kohës, fakt që reflektohet në veçanti në veprat e Pjetër Budit, të Frang Bardhit e të Pjetër Bogdanit.

I njëjti argument, i cekur jo rrallë dhe në rast të përshkrimit apo analizimit të historikut të librit të Gjon Buzukut (1555), përbën një prej aspekteve më të pasaktësuarat sot e kësaj dite, madje dhe i lidhur me hipoteza mbi rrethanat të paqarta të daljes apo realizimit për shtyp të kësaj vepre, me gjasë në një kontekst apo areal në të cilin liturgjia celebronte dhe me elemente të gjuhës shqipe. Duke iu referuar pikërisht vitit që shënohet në pasthënien apo kolofonin e këtij libri, vetë zhvillimet që pasojnë përmbylljen e punimeve të Koncilit të Trentit (1545-1563), saktësimi i autoriteteve që mbikëqyrnin përpilimet e shkruara në gjuhët e vendeve, rinëvizimi i zyrtaritetit të Vulgatës latine në kontekste të transmetimit dhe të receptimit të tekstit biblik, mbeten dhe argumente që mund të mbështesin hipoteza që janë parashtruar si në sprovat që janë shkruar posaçërisht për këtë vepër, si dhe në punimet me një vështrim kolegjal, në të cilat bie në sy dhe një vend i posaçëm që u kushtohet veprave të letërsisë së vjetër shqipe.

Çështjet e njohjes së historikut të librit të Gjon Buzukut janë rimarrë herë pas here dhe në këtë drejtim, dhe vetë rizbulimi i tij në fillim të shekullit të kaluar, bashkë me një vëmendje të shtuar ndaj bibliotekës në të cilën u rigjet dhe më tej, sjellja e kopjeve të para fotografike në vendin tonë falë ngulimit të Atë Justin Rrotës O.F.M., i dha shtysë një interesimi të shtuar që do të reflektohej si me cekjen e ekzistencës në të përkohshmet më në zë të kohës, ashtu dhe me riprodhime tekstesh e pjesësh ndaj të cilave vetë studiuesit patën kujdesin të kishin si burim referencial Vulgatën latine. Qasja ndaj këtij historiku është realizuar në rrugë letërkëmbimi, por dhe në një ecuri metodologjike që para së gjithash bënte të mundur një përafrim me tekste tipike, ndër të cilat spikasin pjesë biblike, por dhe vetë pasthënia, që për konfigurimin tekstor dhe ndërtimet që përmban na lidh natyrshëm me një kulturë të kohës në të cilën vetë libri pa dritën e shtypit. Pothuaj në çdo rasë

të evidentimit të ndërtimit të veprës, të modeleve librore që e përbëjnë, vihet në dukje mungesa e faqeve të para dhe e një kalendarit të parashtruar liturgjik, që nëse do të disponohej, jo vetëm do ta bënte më të qartë konfigurimin e mirëfilltë kësaj vepre, por dhe përkatësinë ndaj përdorimit në kontekste konkrete, që mund të jenë dhe në funksion të një bashkësie të ngushtë që vinte në përdorim gjuhën tonë.¹⁰

Njohja më e mirë jo vetëm e historisë së tipografisë në periudhën që lidhet me daljen në dritë të shtypit të këtij libri, por dhe e kohës në të cilën janë përdorur më shumë shenja të caktuara grafematike, i sjell më afër finalizimit konkret çështjet që prej shumë kohësh janë shtruar e rishtuar në lidhje me këtë të fundit. Trajtesat analitike mbi Konkilin e Trentit dhe konkluzionet e tij janë shoqëruar dhe me reflektimet mbi indeksat e librave të ndaluar, ndaj të cilave që në kohën e daljes ka pasur vështirime kritike dhe nga ana e vet hierarkisë kishtare. Përpilimi i një sërë rregullash nga ana e autoriteteve kishtare ka pasur një vijimësi që duket e reflektuar qartë dhe në rast të daljes së indekseve të tjera, në të cilat bie në sy rimarrja e rregullave të parashtruara që mbas përfundimit të koncilin tridentin. Aty do të dallohen qartë orientime që kanë të bëjnë me autorët, me veprat, me tematikat e caktuara, me variantet e plota biblike, me modele të tjera librore, që mund të ishin dhe të gjinive letrare, por të lidhura sërish me biblikën dhe me aspektin teologjik të trajtimit apo analizimit të saj.

Rregullat e përpiluara në gjuhën latine, me një referim ndaj Konkilit të Trentit dhe autoritetit pontifikal përkatës do të rimerren në disa indekse, dhe në ato të përpiluara në shekujt pasues, në Shtatëqindën e në Tetëqindën në veçanti. Referimi ndaj këtij koncil do të mund të gjurmohet dhe në faqet hyrëse të veprave të Pjetër Budit, bashkë me përmendjen e emrit të Roberto Bellarminos S. I., një aktor i rëndësishëm në ngjarjet e kohës, me cilësi të spikatura dhe në fushë të reformave kishtare. Përpilimet në gjuhën shqipe që shohin dritën e shtypit në dekadat e para të shekullit XVII janë ngushtësisht të lidhura me zhvillimet postridentine dhe me hapat e ndërmarrë në drejtim të librit kishtar në format doracaku, siç dhe rezulton në disa botime e ribotime të së njëjtës tematikë në shqipe dhe në gjuhë të tjera. Doktrina e krishterë dhe Rituali romak do të mund të disponohen dhe në gjuhën tonë falë përpjekjeve të Pjetër Budit (1566-1622), i cili i realizon sprovat e tij pranë një tipografie në Romë, të shënuar qartësisht në frontespicit e vepërave të tij. Në të tilla përpilime dhe në elemente të caktuara të tyre do të mund të gjurmohet lirisht prania e autoriteteve që janë pjesë e miratimit përkatës të tyre, fakt që rezulton dhe në kronika të kohës, në të cilat emrin e prelatit tonë e gjejmë të përmendur

¹⁰ M. Roques, *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f. 10.

më se një herë. Në të vërtetë, janë pikërisht këto indice që do të dallojnë qartësisht veprat që realizohen në fillim të shekullit XVII, por dhe ato që përpilohen më tej e që do të mbartin tipare të lejimit hierarkik dhe një pikëpamje të enteve botuese që lidhen pikërisht me autoritetin e sipërcituar.¹¹

Në shekullin XVII të tilla autoritete marrin një konsolidim që shprehet dhe në tekste të posaçme. Në një prej teksteve të Dicionarit latinisht-shqip të Frang Bardhit do të gjendet dedikimi hyrës që autori u drejton kardinalëve të Kongregacionit të Propagandës, i përpiluar në gjuhën latine dhe që përmban një sërë shprehjesh e ndërtimesh tipike për një model të tillë tekstor. Ky fakt lidhet dhe me vetë daljen në dritë të kësaj vepre nga Tipografia e Propagandës, e iniciuar vite më parë si ent botues. Botime të mëvona, përfshirë Doktrinën e Gjon Nikollë Kazazit (Romë, 1743) do të shihet qartë që realizohen falë së njëjtës përkujdesje. Një interes i tillë gjen shpjegime brenda një kornize zhvillimesh që e sheh librin kishtar dhe atë të praktikës së liturgjisë si një mjet të rëndësishëm edukues, ndërkohë që në studimet tona këtyre botimeve u njihet dhe një vlerë e rëndësishme në pikëpamje të evidentimit të fazave më të hershme të lëvrimin të gjuhës e të teksteve letrare shqipe. Në një pjesë të mirë të studimeve mbi historinë e letërsisë së shkruar shqipe, me një vështrim të orientuar ndaj periudhash dhe ndarjesh kohore që shoqërohen dhe me interpretime të natyrës tematike, pikërisht shekujve që lidhen si me dëshmimin shkrimor përmes veprash më të përcaktuara në objekt dhe natyrë përmbajtësor, u jepet një vend i përveçëm, bashkë me interpretime që në dekadat e fundit janë paraqitur të pasuruara si për arsye të përafrimit tekstor më të lehtësuar, ashtu dhe për një sërë informacionesh që bëjnë të mundur të parashtrohen më qartë e në mënyrë më të thelluar çështje të njohjes së kontekstit të realizimit të tyre.

Në lidhje me librin e Gjon Buzukut, duhet thënë që realizimi i një botimi të plotë kritik e filologjik disa dekada më parë nga Eqrem Çabej (Tiranë, 1968) krijonte një premisë të mirë për të parashtuar studime mbi brendinë dhe tipare të ndërtimeve gjuhësore e letrare që bëheshin më të përafrueshme dhe falë shënimeve të shumta që shoqërojnë në mënyrë të veçantë tekstet e transkribuara që përmbahen në vëllimin e dytë të botimit. Kësaj vepre iu kushtuat jo pak studime që në fillim të shekullit të kaluar,

¹¹ Historiku i njohjes së autoriteteve të tilla, të ndërmenduara në rregullat përkatëse të përpiluara në proces të Koncilit të Trentit apo në referim ndaj punimeve të tij përbën një tjetër argument me rëndësi dhe në funksion të plotësimit të elementeve njohëse të historisë së letërsisë së vjetër shqipe. Në këtë vështrim, vetë tekstet që bëjnë të mundur të introduktohen më natyrshëm të tilla vepra janë një element orientues dhe ndaj pranisë së autoritetit censurues e në këtë rasë, dhe lejues të botimit përkatës.

ndërkohë që studime të plota siç janë ai i Martin Camajt (*Shêjzat*, Romë, 1960) që përbën një ndërmarrje analitike dhe të arrirë në pikëpamje shkencore rivë në qendër të vëmendjes çështje të historikut të veprës, për njohjen e të cilave mjaft kompetenca i përkasin pikërisht njohësit të gjuhëve, por dhe filologut, gjithashtu dhe njohësit të historisë së zhvillimeve kulturore në lidhje me disiplinën e bibliofilisë në Evropë në shekullin XVI.

Njohja e historikut të veprave të letërsisë së vjetër shqipe mbetet një argument që dhe në fokus të punimeve që vijojnë të kenë në vëmendje historinë e letërsisë së shkruar shqipe gjen një hapësirë të çmueshme, duke qenë se çdonjëra prej tyre kontekstualizohet në një sërë vështirësesh që ngërthejnë disa disiplina. Në vështirimin e studiuesve të mesjetës së vonë edhe vetë biografia e autorëve të veprave të kësaj letërsie ka qenë trajtuar dhe reflektuar në shkrime, kërkime e trajtesa të përveçme, fakt që konkretizohet në një sërë botimesh tematike në buletine e revista shkencore të viteve të kaluara.¹²

Në veçanti, vepra e Pjetër Bogdanit, e botuar në vitin 1685 në Padova, i lidh lexuesit dhe studiuesit e saj me një areal të veçantë të Gadishullit Italik, i cili ishte përfshirë herët në zhvillimet e teknologjisë së prodhimit libror, fakt që konkretizohet në vet historikun e një tipografie të përmendur në vijimësi në fjalorë dhe në enciklopedi në të cilat vetë bibliofilia si disiplinë zë një vend të konsiderueshëm.¹³ Në elementet përfaqësuese të kësaj vepre gjurmohen një sërë indicesh që flasin si për kujdesimin e veçantë në përgatitjen për shtyp të saj, ashtu dhe për praninë aktive të mbështetësve të realizimit të saj, një

¹² Jo pak shkrime të Injac Zamputit (1910-1998) orientohen ndaj argumenteve të kësaj natyre: kemi parasysh edhe pikëpamjet e shprehura mbi rrethanat e zbulimit të *Mesharit* të Gjon Buzukut dhe hipotezat mbi mundësinë e përfshirjes së tij në indekse librash të ndaluar në fund të Pesëqindës apo më tej; kemi parasysh gjithashtu dhe shkrimet e thelluara dhe të mbështetura mbi analiza dokumentare në lidhje me rrethanat e vdekjes së Pjetër Budit, një prej autorëve më të rëndësishëm të letërsisë kishtarë shqipe të shekullit XVII. Trajtesat e Injac Zamputit janë cituar dhe vënë në dukje për rëndësinë e tyre dhe në vëllimet e botuara vite më parë mbi historinë e letërsisë së shkruar shqipe (përkatësisht në atë të vitit 1959), duke qenë se ka realizuar studime të përveçme mbi letërsinë e vjetër shqipe. Edhe latinisti e përkthyesi H. Lacaj (1909-1991) i ka kushtuar jetëshkrimit dhe vjershërimit të P. Budit studime të thelluara, të cilat në variantet më të përmirësuara kanë parë dritën e botimit në revistën *Studime filologjike*, përkatësisht gjatë vitit 1966, që mbahej si përvjetor jubilar i lindjes së këtij prelati të historisë e të letërsisë shqiptare.

¹³ Në vetvete, historiku i tipografive të caktuara e në veçanti i atyre nga të cilat kanë dalë veprat e letërsisë së vjetër shqipe përbën një burim të çmuar dhe në kuptimin e gjurmimit të mënyrës së qarkullimit të modeleve të shkronjave të përdorura për secilën prej tyre. Shih në veçanti *Della Stamperia del Seminario di Padova memoria del direttore Gaetano Sorgato*, Padova (coi tipi del Seminario), 1843.

çështje kjo e trajtuar dhe më parë në punimet mbi tekstet e vjetra shqipe, në veçanti në sprovat për t'i dhënë qoftë autorit të veprës një vend të merituar në kujtesën kombëtare shqiptare, ashtu dhe për t'i njohur vetë veprës së tij vlera të pamohueshme në pikëpamje të ndërtimit, të shkrimtarisë së përpunuar, të krerëve dhe argumenteve që përkojnë dhe me prirjet e kohës dhe me perspektivën në të cilën vështroheshin qasjet dhe trajtesat në fushë të teologjisë së krishterë.

Në perspektivë të përpilimit të punimeve të plota mbi historinë e letërsisë së shkruar shqipe dhe në veçanti në lidhje me periudha që paraprijnë shekujt XIX-XX, pikërisht në lidhje me vepra që u përkasin shekujve XVI-XVII çështjet e njohjes së historikut të tyre janë të lidhura ngushtë me një sërë faktorësh: disponimi i të dhënave të plota mbi autorët a përpiluesit e tyre, njohja e një dokumentacioni gjegjës që hedh dritë në një sërë rrethanash që pasurojnë si vetë panoramën e analizimit të vetë veprës, ashtu dhe vetë ecurinë e përmbushjes së saj në tekste dhe përmbajtje. Vetë autorët e veprave të letërsisë së vjetër shqipe, duke u shprehur në pjesë tipike të ndërtimit të tyre, në parathëniet apo në pasthëniet apo kolofonet, kanë kontribuar ndjeshëm në gjurmimin e një historie më të plotë mbi përpilimin përkatës.¹⁴

Dhe pse jo në të njëjtën masë e me objektiva jo plotësisht të njëjta sa i përket tematikës më të ngushtë të veprave, këta autorë dëshmojnë njohje të ndërtimeve të kohës në shprehje, tekste të posaçme, sigla e sintagma që lidhen drejtpërdrejt me një kulturë të tërë përdorimesh e elementesh librare. Në të vërtetë, dhe në kushte të pasurimit të punimeve mbi këtë periudhë të rëndësishme të dëshmimit shkrimor të gjuhës sonë e të hartimit të teksteve që përmbajnë përftesa me një përkatësi të qartë ndaj ndërtimeve letrare si dhe praktikës së liturgjisë, janë pikërisht të tilla tekste që përfaqësojnë brendinë dhe veçantitë e secilës prej tyre.

¹⁴ P.sh., Teksti përmbyllës (*Admonitio de erroribus*) i Dictionarit latinisht-shqip (1635) të Frang Bardhit përmban dhe shprehje të thukëta në gjuhën latine, por dhe vetë vetëdijen e autorit për vështirësinë e përgatitjes së një veprë të tillë për shtyp. Një fakt i tillë rishton çështjen e njohjes së gjuhës shqipe në një kontekst të tillë, si dhe të përfshirjes së veprave me tematikë të përcaktuar në veprimtaritë botuese të kohës. Për interpretime të posaçme mbi pjesët introductive apo dhe përmbyllëse të këtyre veprave, në veçanti të atyre të Pjetër Budit, rikujtojmë paragrafët gjegjëse interpretuese në veprën e mirënjohur të filologut frëng Mario Roques (1875-1961), pikërisht *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f. 22-31.

Evalda PACI

SUMMARY

THE HISTORY OF ANCIENT ALBANIAN LITERARY WORKS: AN IMPORTANT PREMISE IN ANALYTICAL TREATMENT OF THEIR RECOGNITION

Our discussion focuses on the significance of gaining a thorough understanding of the historical context surrounding the origin and creation of early Albanian literary pieces. These texts were heavily influenced by the institutions of printing during specific cultural movements across Europe. This argument has caught the interest of scholars studying ancient Albanian works, as they strive to fill in the gaps of the historical narrative surrounding the production of Albanian literature in the 16th and 17th centuries.

During the period leading up to the completion of these literary works, printing companies and editing centers emerged and grew in the Italian region. This development had a notable impact on the authors of these works, particularly the compilers of handbooks and dictionaries. These authors were under pressure to adhere to strict hierarchical structures when seeking approval for their printing, a process that gained increasing significance in the years and decades following the conclusion of the Council of Trent (1545-1563). In fact, this approval process was even mentioned in the introductory texts of these works. Thus, the presence and role of authorities responsible for granting printing approval played a significant role in the history of Albanian church literature produced during the 16th century and beyond.